



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:103648

Datë: 30.10.2024

Numri i dokumentit: 06371721

C.nr.344/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësve E (H) H dhe Sh (V) H, që të dy nga Rahoveci, kundër të paditurve: P.T.S, D.T.S, J.T.S, Zh.A.S V.T.S, S.T.S, V1.T.S dhe M.S.S, që të gjithë nga Rahoveci, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 3,100.00 euro, jashtë seancës, më datën 30.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditësve E (H) H dhe Sh (V) H, që të dy nga Rahoveci, në këtë çështje juridike, për shkak të çështjes së gjykuar - res iudicata.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit E (H) H dhe Sh (V) H, që të dy nga Rahoveci, më datën 02.04.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurve: P.T.S, D.T.S, J.T.S, Zh.A.S V.T.S, S.T.S, V1.T.S dhe M.S.S, që të gjithë nga Rahoveci, kanë parashtruar padinë për vërtetim të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 3,100.00 euro.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka konstatuar faktin se lidhur me këtë çështje juridike e cila është objekt i kësaj padie, është vendosur me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër të lëndës C.nr.345/2024, të datës 21.06.2024, ndërsa në SMIL e evidentuar me numër: 2024:109913. Kjo gjykatë këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 pika d., të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.344/2024, më datën 30.10.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.